

VENDIM
Nr. 118, datë 17.2.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 23,
DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT
TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “...1 751 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, përmendur në pikën 1 të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në ndarjen “Gr.4 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” dhe në ndarjen “Gr.13 Ministria e Shëndetësisë” shtohet nënndarja sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Emërtesa “Punonjës protokoli/arkivi”, e përmendur në ndarjen “Gr. 6 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (aparati)”, bëhet “specialist arkivi” dhe emërtesa “punonjës mirëmbajtjeje”, përmendur në nënndarjen “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, bëhet “punonjës shërbimi”.

c) Pas ndarjes “Gr. 28 Prokuroria e Përgjithshme” shtohet ndarja “Gr. 29 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 4, pas fjalëve “... si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional” shtohen “... dhe pedagogë të jashtëm/trajnerë të angazhuar në formimin profesional të magjistratëve.”.

II. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
04	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	6			
	<i>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</i>	4	Specialistë	8 orë/ditë	6-muaj
	<i>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	<i>Agjencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	6-muaj
13	Ministria e Shëndetësisë	2			
	<i>Spitali Psikiatrik Elbasan</i>	2	Kaldaistë	8 orë/ditë	janar-mars;nentor-dhjetor
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	20			
	<i>Gjykata Shkallës Parë Krimet e Renda</i>	1	Sanitar	8 orë / ditë	6-muaj
	<i>Gjykata e Rrethit Durrës</i>	1	Nëpunës gjyqësor	8 orë / ditë	korrik - dhjetor
	<i>Gjykata e Rrethit Elbasan</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Elbasan</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Shkodër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Shkodër</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Fier</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Fier</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Vlorë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Vlorë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Korçë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Korçë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Tiranë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Vlorë</i>	1	Sanitar	5 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë</i>	1	nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata Administrative Shkallës Parë Durrës</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata Administrative Shkallës Parë Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore